



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 450 Prot.

Tiranë, më dt. 24.11.2017

VENDIM

Nr.334, dt. 24.11.2017

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 24.11.2017, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ndërtimi i HEC Ziçisht”, Bilisht Korçë, me subjekt aplikues “BEGEM ENERGJI” sh.p.k.
2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture: “Restaurim banese Mihallaq Ziçishtit, Devoll” hartuar nga DRKK Korçë.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Mirela Kumburo Furxhi



SEKRETAR I KKR I DELEGUAR

Arta Dollani